

22-23
Faza 1

RUBRIKA I

TESTI I INTELIGJENCES

TEZA 2

1. Cili numër mungon në këtë seri numrash: "2, 8, 14, ?, 26, "
a) 19; b) 20; c) 18; d) 21.

2. Me cilin traktat u krijua Komuniteti Ekonomik Evropian?
a) Traktati i Lisbonës;
b) Traktati i Nisës;
c) Traktati i Amsterdami;
d) Traktati i Romës.

3. Cili numër duhet të vijë në radhë në këtë seri numrash: "36, 12, 24, 21, 7, 14, 18, 10, "
a) 16; b) 30; c) 8; d) 28.

4. Fjala "Magjistrat" vjen nga:
a) Persia
b) Roma e lashtë
c) Greqia e lashtë
d) Hebraishtja

5. Pas 13 vjetësh, moshë e përbashkët të tre vëllezërve të mi do të jetë 94 vjeç. Po pas 9 vjetësh sa do të jetë?
A: 85
B: 82
C: 97
D: 98.

6. Sa vjet kaloi Nelson Mandela në burg?
a) 21 b) 23 c) 25 d) 27



7. Në një rrugë janë në rresht 60 shtëpi. Asnjë prej shtëpive nuk ka numrin e saj të vendosur mbi të. Ato duhet të numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme nga 1 deri në 60. Sa katra do të duhen gjatë këtij numërtimi?

- a) 15
- b) 6
- c) 16
- d) 12.

8. Cili nga të mëposhtmit është i ndryshëm nga katër të tjerët?


- a) Portugalia
- b) Bullgaria
- c) San Marino
- d) Suedia

9. Cili numër duhet të vijë në radhë në këtë seri numrash?: "7, 11, 14, 15, 19, 22, 23, ...?"

- a) 24;
- b) 25;
- c) 27;
- d) 29

10. Cili mal është më i lartë?

- a) Tomorri
- b) Jezerca
- c) Gramozi
- d) Nemërçka



RUBRIKA II
LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,
E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI

TEZA 16

LEGJISLACIONI I BE

11. Cilat prej këtyre akteve komunitare kanë fuqi juridike detyruese

- a) Rregulloret, vendimet dhe opinionet
- b) Direktivat, vendimet dhe opinionet
- c) Rregulloret, rekomandimet dhe vendimet
- d) Rregulloret, direktivat dhe vendimet

12. Rendi kronologjik i Traktateve të cilat amendojnë Traktatin e Komunitetit Europian është si vijon:

- a. Traktati i Bashkimit Europian (TBE), Akti Unik Europian (AUE), Traktati i Nicës, Traktati i Amsterdimit
- b. Akti Unik Europian (AUE), Traktati i Bashkimit Europian (TBE), Traktati i Amsterdimit, Traktati i Nicës
- c. Traktati i Amsterdimit, Akti Unik Europian (AUE), Traktati i Nicës, Traktati i Bashkimit Europian (TBE)
- d. Traktati i Komunitetit Europian nuk është amenduar.

13. Për çfarë arsye Shtetet Anëtare mund të kufizojnë të drejtat e lëvizjes së lirë?

- a. Shkaqet ekonomike.
- b. Shkaqet mjedisore.
- c. Politika publike, siguria publike ose shëndeti publik.
- d. Shkaqet arsimore.

E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

14. Mendimi këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë:

- a) Mund të jetë i detyrueshëm, kur gjykata e arsyeton se mund t'i japë zgjidhje një mosmarrëveshjeje
- b) Nuk ka vlerë të detyrueshme në asnjë rast
- c) Mund të jetë i detyrueshëm, kur organizata që e kërkon e vendos vetë një gjë të tillë.

15. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB:

- a) Janë të detyrueshme në çdo rast
- b) Janë të detyrueshme vetëm kur Këshilli i Sigurimit ndërhyt për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së OKB
- c) Janë të detyrueshme edhe në rastet kur Këshilli i rekomandon palët që çështjen ta zgjidhin me mjete paqësore.

16. Vendimet e Asamblese së Përgjithshme të OKB kanë karakter detyrues kur:

- a) Kanë të bëjnë me çështje të organizimit të brendshëm të OKB.
- b) Kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.
- c) Kanë të bëjnë me ndihmën për zhvillim.



RUBRIKA II
LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,
E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI

- c. Çështja konsiderohej përfundimisht e zgjidhur me vendimin e Komisionit Trepalësh (SHBA, Francë, Britani e Madhe)

E DREJTË E KRAHASUAR

17. Cili ishte juristi që praktikoi për herë të parë të drejtën e krahasuar:

- a. Fojerbah;
- b. Mitermaier;
- c. Zaharia.

18. Periudha e lulëzimit të së drejtës së krahasuar në SHBA ishte:

- a. Shek.18;
- b. Shek. 19;
- c. Shek. 20.

HISTORI

19. Gjakmarrja në të drejtën zakonore ishte:

- a. Fenomen shqiptar;
- b. Jepej si vendim nga gjykata;
- c. Vetëgjyqësi;
- d. Edhe b edhe c.

20. Në Angli:

- a. Shprehje e pluralizmit politik është alternimi në pushtet i dy partive;
- b. Partitë që alternohen sot janë Torët dhe Vigët;
- c. Partitë që alternohen sot janë Konservatorët dhe Liberalët;
- d. Partitë që alternohen sot janë Republikanët dhe Liberalët.



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

TEZA 20

21. Me se janë shprehur pjesët e ligjëratës të shënuara me të zeza:

“Kodi penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.”

- A) Mbiemër;
- B) Emër;
- C) Përemër pronor;
- D) Ndajfolje.

22. Shërbejnë si folje ndihmëse:

- A) Mund, duhej;
- B) Kam, jam;
- C) Filloj, nis;
- D) Mbaroj, përfundoj

23. Gjeni sa trajta të shkurtra janë përdorur në fjalinë e mëposhtme:

“Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.”

- A) 1; B) 3; C) 5; D) 7.

24. Foljet: (ai) lulëzofte, (ti) qofsh, (ai) pastë janë në mënyrën:

- A) Dëshirore; B) Urdhërore; C) Kushtore; D) Dëftore.

25. Sa fjali të thjeshta ndodhen në materialin e mëposhtëm:

“Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtare, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”

- A) Asnjë; B) 1; C) 2; D) 3.

26. Fjala “ përdorim” është:

- A) E parme;
- B) E përbërë;
- C) E prejardhur;
- D) Dhanore.

27. Përcaktoni rasën e emrit të nënvizuar në fjalinë : “ Lajmi erdhi prej shokëve.”



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

- A) Emërore;
- B) Gjinore;
- C) Rrjedhore;
- D) Dhanore.

28. Cili është kuptimi i shprehjes frazeologjike: “ Ti bëj bisht sherrit”:

- A) Të pajtohem me shokun;
- B) Të bëj diçka me vlerë;
- C) T’i shmangem grindjes;
- D) Të besoj shokun.

29. Sa fjalë janë shkruar gabim në grupin e fjalëve:

Përtacëri, besnikëri, robri, mjeksi, burrëri, spiranc, gojdhënë, pafundsi, trakëtorist.

- A) 8;
- B) 7;
- C) 6;
- D) 5.

30. Cila fjalë ka marrë njëkohësisht parashtesë dhe prapashtesë?

- A) Shqetësoj;
- B) Zbukuroj;
- C) I palëvizshëm;
- D) Përpunoj.

31. Cila nga fjalitë e mëposhtme ka vetëm një gjymtyrë kryesore?

- A) Nuk dëgjonim më asnjë zhurmë.
- B) Vajza doli me vrap.
- C) Qeni ulërinte.
- D) Ai nuk ishte i qetë.

32. Cila fjalë nuk merr antonim?

- A) Hap;
- B) Anësi;
- C) Ëndërroj;
- D) Vonë.

33. Rrethoni alternativën e gabuar:

- A) Gjithshka;
- B) Gjithkund;
- C) Gjithsecili;
- D) Vetvetiu.

34. Fjala “abandonoj” ka si gjegjëse shprehjen frazeologjike:

- A) Hundë e buzë;
- B) I jap duart;
- C) Hap sytë;
- D) E ka halë në sy.



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

35. Komunikimi më i saktë është:

- A) Me shkrim;
- B) Me gjeste;
- C) Me piktura;
- D) Me flamurë.

36. Gjeni sa përemra janë përfshirë në tekstin e mëposhtëm:

“Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.”

- A) 1;
- B) 2;
- C) 3;
- D) 4.

37. Çfarë shpreh fjalia: “ Ç’ njerëz janë këta që nuk pyesin për ligjin ! “:

- A) Habi;
- B) Indinjatë;
- C) Përbuzje;
- D) Zemërim.

38. Rregulloret shkruhen me stilin:

- A) Letrar;
- B) Administrativo-juridik;
- C) Politiko-shoqëror;
- D) Shkencor- teknik.

39. Përemrat: *dikush, gjithsecili, ca, disa, të gjithë* janë:

- A) Pyetës;
- B) Lidhorë;
- C) Të pacaktuar;
- D) Vetorë.

40. Në fjalinë :” Po të thoshte të vërtetën, do të lehtësohej.”, fjalëza “ Po” është:

- A) Lidhëz nënrenditëse;
- B) Pjesëz pohuese;
- C) Lidhëz bashkërenditëse kundërshtuese;
- D) Asnjëra prej tyre.



**RUBRIKA IV
PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM**

TEZA 15

41. Supozimi se vajzat zhvillojnë superego më të dobët se djemtë bie në kundërshtim me:

- a. nivelet e larta të statusit të viktimës që kanë vajzat
- b. prirjen e vajzave drejt nënshtrimit
- c. prirjen e vajzave për tu stigmatizuar dhe fajësuar
- d. prirjen e vajzave për tu angazhuar në pak sjellje kriminale

42. Në procesin e deindividualizimit, rol të rëndësishëm luan:

- a. norma e reciprocitetit
- b. norma grupore
- c. anonimati
- d. faktorët biologjik dhe social

43. Profilet psikologjike

- a. kanë vlerë vetëm për profilin psikologjik aktual të individit
- b. nuk janë parashikuese të sjelljes së ardhshme
- c. paraqesin një tablo të sjelljeve të individit
- d. të gjitha më sipër

44. Psikiatria forensike:

- a. është disiplinë e psikologjisë forensike
- b. përfshin zbatimin e disa disiplinave në studimin e sjelljes kriminale (sociologji, psikologji, gjeografi)
- c. është disiplina që fokusohet në trajtimin e të burgosurve me psikopatologji
- d. paraqet një bazë më shkencore sesa disiplinat e tjera, për shkak të mbështetjes në studime eksperimentale

45. Dehumanizimi ka si qëllim:

- a. nxitjen e nacionalizmit
- b. nxitjen e urrejtjes
- c. rritjen e inteligjencës
- d. rritjen e pakënaqësisë



RUBRIKA IV
PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM

TEZA 15

46. Vrasja e parë nën këndvështrimin e përfitimit psikologjik të vrasësit:

- a. lidhet me mbijetimin dhe zhvillimin e fantazive
- b. lidhet me ndjenjën e kontrollit të vrasësit
- c. lidhet me tendencat e sigurisë
- d. çliron tensionin agresiv të autorit

47. Modelet e të menduarit të personave që priren drejt krimit karakterizohen nga:

- a. prania e prespektivave të shumta
- b. ndjeshmëria e lartë
- c. perceptimi i vetes si viktima
- d. të gjitha më lart

48. Teoria sociale e të mësuarit e shpjegon agresivitetin:

- a. sipas konflikteve të pandërgjegjshme
- b. bazuar në fantazinë dhe imagjinatën
- c. sipas modelit të ndëshkimit dhe shpërblimit sjellor
- d. të gjitha më sipër

49. Vetëvlerësimi i ulët tek dhunuesit lidhet me:

- a. paparashikueshmërinë e sjelljes së tyre
- b. nevojën për kontroll dhe pushtet
- c. praninë e figurave autoritare në fëmijëri
- d. marrëdhëniet ambigje në fëmijëri

50. Cili nga llojet e agresiviteti është më i përhapur tek vajzat , krahasuar me djemtë?

- a. agresiviteti armiqësor
- b. agresiviteti instrumental
- c. agresiviteti fizik
- d. agresiviteti relational



RUBRIKA V

ETIKË E SJELLJE QYTETARE

TEZA 10

Mbi rregullat e sjelljes dhe të etikës së prokurorit

- 51) Prokurori i Përgjithshëm shkarkohet:
- a) Kryen shkelje të rënda profesionale;
 - b) Kreyen shkelje të rënda etike;
 - c) Është denuar me vendim të formës së prerë;
 - d) a) edhe c) ;
 - e) a) edhe b) edhe c).
- 52) Këshilli i Lartë i Prokurorisë:
- a) bën publike standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve;
 - b) rishikon herë pas here rregullat dhe, kur është e nevojshme, i ndryshon ato;
 - c) analizon shkallën e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës dhe raporton publikisht për gjetjet;
 - d) edhe a) edhe b)
 - e) edhe a) edhe b) edhe c)
- 53) Këshilltari për Etikën e Prokurorit caktohet nga:
- a) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
 - b) Kryetari i cdo institucioni;
 - c) Kryeprokurori;
 - d) Asnjëra prej tyre.
- 54) Këshilltar për Etikën duhet të caktohet nga :
- a) Radhët e prokurorëve që plotësojnë kushtet ligjore
 - b) për të qenë prokuror dhe ka njohuritë e duhura mbi çështje të etikes
 - c) Radhët e prokurorëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë prokuror në apel prokuror dhe ka njohuritë e duhura mbi çështje të etikes
 - d) Radhët e prokurorëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë prokuror të Prokurorisë së Përgjithshme prokuror dhe ka njohuritë e duhura mbi çështje të etikes
 - e) Asnjëra prej tyre.
- 55) Këshilltari për Etikën shërben për:
- a) Një periudhë 2-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje;
 - b) Një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një here;
 - c) Një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një here;
 - d) Nuk ka mandat të përcaktuar;
 - e) Asnjëra prej tyre.



RUBRIKA V
ETIKA PROFESIONALE

56) Cili prej pohimeve të mëposhtëm është i saktë?

- a) Gjatë një séance gjyqësore, gjyqtari duhet të respektoje solemnitetin e procesit dhe të mbajë veshje të posacme.
- b) Gjatë një séance përgatitore që lidhet ngushtë me çështjet procedurale, gjyqtari duhet të respektojë solemnitetin e procesit dhe të mbajë veshje të posacme.
- c) Në kontesktin e intervistave të tij me median, gjyqtari duhet të ruajë imazhin e gjyqësorit duke mbajtur pelerinën gjyqësore
- d) Përgjigjet A dhe B janë të sakta
- e) Përgjigjet A, B dhe C janë të sakta

57) Gjyqtari X po shqyrton një çështje penale që ka të bëjë me vjedhje. Një gjyqtar i dytë nga e njëjta gjykatë, Gjyqtari Y, edhe ai po shqyrton një çështje të ngjashme, i pandehuri i së cilës është një i njohur i të pandehurit të çështjes së Gjyqtarit X. Në fund të gjyqit, Gjyqtari X jep vendimin për ta liruar të pandehurin, por i përmend atij se i njohuri i tij, gjyqi i të cilit ende vazhdon, nuk ka gjasa të jetë aq me fat sa ky i pandehur. Cili prej pohimeve të mëposhtëm është i saktë?

- a) Gjyqtari X kreu një shkelje etike duke dhënë opinionin e tij në lidhje me një çështje që vazhdon ende.
- b) Gjyqtari nuk i shkeli detyrimet e tij etike, sepse opinion i tij për çështjen e Gjyqtarit Y nuk ndikon në rezultatin e asaj çështje
- c) Gjyqtarit X i lejohej të bënte një deklaratë, duke qënë se procedurat kundër të pandehurit kishin përfunduar
- d) Përgjigjet B dhe C janë që të dyja të sakta
- e) Asnjëri prej pohimeve të mësipërm nuk është i saktë

58) Ju jeni gjyqtar prej disa vitesh. Një universitet privat po organizon një konferencë me temë administrimin gjyqësor, për të diskutuar mbi problemet dhe zgjidhjet potenciale për sfidat me të cilat përballlet sistemi. Duke konsideruar eksperinecën tuaj të gjatë në gjyqësor, ata ju kanë ftuar për të dhënë një prezantim në konferencën në fjalë. A mund ta pranoni?

- a) Jo. Kjo përbën një shkelje të pavarësisë suaj gjyqësore. Ju nuk mund të merrni pjesë në një aktivitet që organizohet nga anjë universitet privat.
- b) Po, ju jeni i lejuar të pranoni, por ju nuk duhet ta identifikoni veten si gjyqtar ose anëtar i një gjykate kur të bëni prezantimin
- c) Jo, ju nuk mund të shprehni në public opinionin tuaj mbi çështje që ndikojnë në efincencën dhe punën e gjyqësorit
- d) Po, kjo nuk është çështje etike pasi qëllimi i konferences është të sjellë në vëmendje një aspekt të rëndësishëm të punës së gjyqësorit
- e) Asnjëra prej të mësipërmeve.



RUBRIKA V
ETIKA PROFESIONALE

- 59) Për shumë vite me radhë, Avokati A ka ofruar këshilla ligjore dhe përfaqësim për z. X dhe znj. Y në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me biznesin e familjes dhe me pronat e zotëruara nga çifti. Javën e fundit, znj. Y i tha Avokatit A që çifti do të zgjidhte martesën, dhe se ajo dëshironte të merrte këshilla ligjore rreth të drejtave të saj. Në veçanti znj. Y i kërkoi Avokatit A ta ndihmonte për të siguruar të drejtat e saj rreth pronave dhe biznesit të çiftit në kuadrin e zgjidhjes së martesës. Duke mos u ndjerë rehat me këtë situatë dhe duke pasur frike se mund të kishte konflikt interesi, Avokati A i sugjeron znj. Y që të konsultohet me një koleg tjetër të të njëjtës zyrë avokatie, Avokatin B, i cili është në partneritet profesional me Avokatin A. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë?
- a) Avokati A ka detyrim besnikërie ndaj znj. Y dhe, për pasojë, ai duhet të kishte pranuar ta këshillonte rreth të drejtave të saj në kuadrin e zgjidhjes së martesës.
 - b) Avokati B që këshillon znj. Y rreth zgjidhjes së martesës nuk krijon problem të konfliktit të interesit sepse si Avokati A dhe Avokati B janë të detyruar të respektojnë sekretin profesional.
 - c) Avokati A mund të vazhdojë të japë këshilla ligjore për z. X dhe znj. Y rreth çështjeve të pronave dhe biznesit të tyre, por zyra e avokatisë nuk duhet t'i japë këshilla znj. Y në lidhje me zgjidhjen e martesës.
 - d) Avokati A nuk duhet të përfaqësojë më çiftin, por Avokati B lejohet të këshillojë znj. Y.
 - e) Avokati A nuk duhet të përfaqësojë dhe të mbrojë më çiftin për çështjet e pronave dhe biznesit, dhe Avokati B nuk duhet t'i japë këshilla znj. Y rreth të drejtave të saj në kuadrin të zgjidhjes së martesës.
- 60) Jeni anëtar i një organizate. Pjesëmarrja juaj në këtë organizatë është miratuar nga eprori juaj. Megjithatë asnjë anëtar i organizatës nuk ju ka folur për çështjen, ju keni lexuar një letër në një gazetë nga organizata, e cila ka të bëjë me një hetim që iu është caktuar. Letra thotë se cilat akuza do të ngrihen. Në marrjen e vendimit për akuzat që do të ngrihen, a mund të merrni në konsideratë atë që thotë organizata në letrën që i dërgon gazetës?
- a) Po, sepse eprori juaj e ka miratuar pjesëmarrjen në këtë organizatë;
 - b) Po, sepse asnjë nuk iu ka kontaktuar personalisht;
 - c) Jo, sepse vendimet duhet t'i merrni në mënyrë të pavarur bazuar në rezultatet e hetimit;
 - d) Jo, sepse nuk ka asnjë mënyrë që të verifikoni atë që thotë organizata në letër.



RUBRIKA VI
ADMINISTRATIVE - KUSHTETUESE

Teza 12

Gjeni pohimin e saktë

61. Akti i delegimit të kompetencave:

- a) nuk është i nevojshëm të botohet,
- b) nuk është i nevojshëm të bëhet i njohur për publikun,
- c) është i detyrueshëm të botohet në Fletoren Zyrtare, në rastet e delegimit nga organet e administratës qendrore,
- d) asnjëra prej tyre.

62. Sipas ligjit, etika në administratën publike:

- a) nuk ka të bëjë në asnjë rast me përdorimin e kohës së punës nga ana e punonjësit,
- b) përfshin edhe detyrimin për të përdorur kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare,
- c) përfshin detyrimin për të mos përdorur kohën e punës për asnjë qëllim tjetër përveç se për ushtrimin e detyrës sipas pozicionit, qoftë edhe në rastet kur punonjësi ka një autorizim zyrtar që mundëson angazhimin në veprimtari të jashtme të lejuara (si për shembull mësimdhënia).

63. Prefekti:


- a) është organ që varet nga Këshilli i Qarkut,
- b) është kryetar i këshillit të qarkut meqë kushtetuta e përcakton atë si përfaqësues në qark,
- c) merr masa disiplinore ndaj punonjësve të organeve të qeverisjes vendore,
- d) është organ që verifikon ligjshmërinë e akteve normative të organeve të njësisve të qeverisjes vendore.

64. Masa e dënimit me gjobë për kundërvajtjet administrative:

- a) nuk mund të jetë në asnjë rast fikse, por gjithmonë me kufij minimalë dhe maksimalë,
- b) për rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit nuk duhet të jetë më e madhe se 20 mijë lekë,
- c) përcaktohet nga vetë organi që konstaton kundërvajtjen administrative në bazë të vlerësimeve diskreciale të tij.

65. Mosparaqitja e provave nga organi publik në datën e seancës gjyqësore:

- a) Detyron gjykatën të caktojë gjobë ndaj titullarit të organit publik dhe të shtyjë seancën gjyqësore për një datë tjetër,
- b) Detyron gjykatën t'i caktoj organit publik një afat të dytë, jo më vonë se 5 ditë pas dates së seancës gjyqësore.
- c) I jep të drejtë gjykatës të konsiderojë të provuar faktet e pretenduara nga pala tjetër, për provimin e të cilave janë kërkuar këto prova.



Teza 12

E DREJTA KUSHTETUESE

I. Rrethoni alternativën e saktë

66. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij sipas Kushtetutës, nxjerr:
- vendime
 - urdhëresa
 - udhëzime
67. Avokati i Popullit, kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike:
- bën rekomandime
 - fillon procedimin disiplinor
 - vendos sanksione me gjobë
68. Kur ndaj gjyqtarit caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" për kryerjen e një veprë penale, ai pezullohet nga detyra me vendim të:
- Këshillit të Lartë Gjyqësor
 - Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar
 - Gjykatës së Lartë
69. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë shkarkohet nga:
- Kuvendi
 - Gjykata Kushtetuese
 - Presidenti i Republikës
70. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e forcave të armatosura, kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin, bëhet me:
- dekret të Presidentit
 - vendim të Kuvendit
 - vendim të Këshillit të Ministrave



RUBRIKA VII

E DREJTA FAMILJARE

Teza 14

71. **Rretho përgjigjen e saktë: Kërkesa në gjykatë për autorizimin e lidhjes së martesës së të miturit:**

- a. Duhet të bëhet vetëm nga përfaqësuesi ligjor i të miturit
- b. Bëhet nga i mituri pasi të merret pëlqimi i përfaqësuesit ligjor të të miturit
- c. Bëhet nga vetë i mituri që dëshiron të lidhë martesë
- d. Bëhet nga nëpunësi i gjendjes civile

72. **Rretho përgjigjen e saktë: Lidhja e krushqisë në rastin e lidhjes së martesës:**

- a. Do të konsiderohet pengesë martesore në çdo rast;
- b. Do të konsiderohet pengesë kur pengesa është vërtetuar me vendim gjyqësor;
- c. Do të konsiderohet pengesë kur lidhja krijon pamundësi të konsumimit të martesës;
- d. Do të konsiderohet pengesë në rastin lidhjeve midis vjehrrës/it dhe dhendërrit/nuses.

73. **Rretho përgjigjen e saktë: Bashkëshortët me marrëveshje:**

- a. Mund të shmangin disa të drejta dhe detyrime martesore;
- b. Mund të vendosin që njëri bashkëshort të marrë më shumë prej detyrimeve që burojnë nga martesa;
- c. Mund të parashikojnë detyrime për personat e tretë;
- d. Asnjë më sipër

74. **Rretho përgjigjen e saktë: Në rastet kur bashkëshortët që kanë mbiemra të ndryshëm dhe nuk arrijnë marrëveshje, sipas Kodit të Familjes:**

- a. Fëmijët në çdo rast do të marrin mbiemrin e të atit;
- b. Nëna mund të kërkojë në gjykatë që fëmijët të marrin mbiemrin e saj nëse mbiemri i bashkëshortit nuk është mbiemri i tij i origjinës, por i ish-bashkëshortes së vdekur;
- c. Fëmijët do të marrin mbiemrin e të dy prindërve të renditur sipas alfabetit;
- d. Nëna nuk mund të kërkojë në gjykatë që fëmijët të marrin mbiemrin e saj.



RUBRIKA VII

TEZA 14

E DREJTË TREGTARE

75. **Aplikimi për regjistrim fillestar i një shoqërie kolektive bëhet:**
- nga administratorët e shoqërisë;
 - nga të gjithë ortakët e shoqërisë;
 - nga administratorët dhe ortakët e shoqërisë;
 - asnjë prej tyre.
76. **Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme në SHPK, asamblea e përgjithshme mund të marrë vendim të vlefshëm nëse në të marrin pjesë :**
- ortakë me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave;
 - ortakë me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave;
 - ortakë me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 75% të kuotave;
 - asnjë prej tyre.
77. **Çregjistrim në rast vdekje i një personi fizik kryhet nga:**
- nga zyra e gjendjes civile;
 - nga trashëgimtarët e personit fizik;
 - nga çdo person i interesuar;
 - asnjë prej tyre.
78. **Administratori, i cili nuk është anëtar i Këshillit të Administrimit:**
- mund të dorëhiqet në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Këshillit të Administrimit;
 - mund të dorëhiqet nga detyra e tij vetëm mbas emërimit të administratorit të ri nga ana e Asamblesë së Përgjithshme;
 - mund të heqë dorë nga detyra e tij vetëm nëse miratohet fillimi nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe më pas, miratohet me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme;
 - asnjë nga përgjigjet e mësipërme.

E DREJTË PUNE

79. **Kur kontrata lidhet për më shumë se 3 deri në 5 vjet, ajo mund të zgjidhet nga punëmarresi:**
- pas 1 viti;
 - pas 3 vjetesh;
 - pas 5 vjetesh.
80. **Zgjidhja e kontratës individuale të punës njoftohet me shkrim nga punëdhënësi, brenda një afati prej:**
- nga 48 orë deri në një javë pas takimit;
 - nga 24 orë deri dy javë pas takimit;
 - nga 48 orë deri tri javë pas takimit.



RUBRIKA VIII
PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE
TEZA 19

§1) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqin dorë nga ankimi, derisa nuk ka filluar relatimi i çështjes në seancë gjyqësore;
- b. Pala mund të heqë dorë nga rekursi, derisa nuk ka filluar relatimi në seancë gjyqësore;
- c. Heqja dorë nga rekursi në Gjykatën e Lartë bëhet me gojë ose me shkrim;
- d. Rekursi i deklaruar i papranueshëm mund të paraqitet përsëri, në qoftë se nuk ka mbaruar afati i caktuar me ligj.

§2) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues prej tre gjyqtarësh në çdo rast që vlera e padisë është mbi 20 milion lekë;
- b. Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues prej tre gjyqtarësh paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave;
- c. Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues prej tre gjyqtarësh paditë për pjestimin e pasurisë.

§3) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Personi i tretë i thirrur në gjykim mund të zërë vendin e një prej palëve në gjykim, kur gjykata gjatë hetimit të çështjes, vëren se pada duhej të ishte ngritur nga ose kundër tij;
- b. Personi i tretë i thirrur në gjykim mund të zërë vendin e një prej palëve në gjykim, kur për këtë ka pëlqimin e palës për të cilën ka ndërhyrë;
- c. Personi i tretë i thirrur në gjykim mund të zërë vendin e një prej palëve në gjykim, kur për këtë ka pëlqimin e të palëve në proces;

§4) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Rregulla të hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të gjykatës;
- b. Rregulla të hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të kryetarit të gjykatës;
- c. Rregulla të hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë;
- d. Rregulla të hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

§5) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Radha sipas së cilës sendet e luajtshme të debitorit të sekuestruara nga përmbaruesi gjyqësor duhet të shiten në ankand, caktohet nga përmbaruesi gjyqësor;
- b. Radha sipas së cilës sendet e luajtshme të debitorit të sekuestruara nga përmbaruesi gjyqësor duhet të shiten në ankand, caktohet nga përmbaruesi kreditori;
- c. Radha sipas së cilës sendet e luajtshme të debitorit të sekuestruara nga përmbaruesi gjyqësor duhet të shiten në ankand, caktohet nga debitori.



TEZA 19

86. Rrethoni alternativën e gabuar:

- a. Kontrata me detyrime juridike reciproke përbën një veprim juridik të njëanshëm.
- b. Kontrata me detyrime juridike reciproke përbën një veprim juridik të dyanshëm.
- c. Kontrata ku njëra palë ka të drejta dhe tjetra ka detyrime është kontrata është e njëanshme.

87. Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a) Në një marrëdhënie detyrimi solidar, ekzekutimi i detyrimit nga njëri prej debitorëve çliron nga detyrimi vetëm atë debitor.
- b) Në një marrëdhënie detyrimi solidar, ekzekutimi i detyrimit nga njëri prej debitorëve i çliron nga detyrimi të gjithë debitorët e tjerë.
- c) Kreditorët nuk mund të jenë solidarë, vetëm debitorët mund të jenë solidarë.

88. Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a) Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqatës mund të përdoren për të sjellë të ardhura që ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet anëtarëve të shoqatës.
- b) Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqatës mund të përdoren për të sjellë të ardhura që përdoren për realizimin e veprimtarive, për të cilat është krijuar shoqata.
- c) Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqatës mund të përdoren për veprimtari fitimprurëse.

89. Rrethoni përgjigjen e gabuar:

- a. Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzënësit përkatës.
- b. Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzënësave përkatës.
- c. Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor nuk shtrihet edhe ndaj dorëzënësit përkatës.

90. Rrethoni përgjigjen e gabuar:

- a. Nuk mund të trashëgojë si i padenjë ai që me dashje ka vvarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
- b. Nuk mund të trashëgojë si i padenjë ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.
- c. Nuk mund të trashëgojë si i padenjë ai që ka vvarë ose ka tentuar të vrasë me cdo formë faji trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij.



RUBRIKA IX
E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE
TEZA Nr. 7

91. Lidhur me masën e sigurimit “garancia pasurore” është i vërtetë pohimi:

- a) Nuk mund të bashkëshoqërohet me asnjë masë tjetër sigurimi;
- b) Caktohet vetëm si alternativë e njëres nga masat e arrestimit;
- c) Shuma e garancisë caktohet nga gjykata, në rast se prokurori jep pëlqimin;
- d) Garancia pasurore mbulohet vetëm nga i pandehuri dhe familja e tij;
- e) Asnjëri prej pohimeve të mësipërme nuk është i vërtetë.

92. Masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton:

- a) dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit;
- b) dënim me burgim më të lartë në maksimum se dy vjet;
- c) dënim me burgim më të lartë në minimum se një vit;
- d) çdo lloj dënimi, mjafton që të mos jetë kundërvajtje penale;
- e) çdo lloj dënimi kur subjekti kryen detyra drejtuese.

93. Në konceptin e provave materiale nuk përfshihen:

- a) mjetet për realizimin e veprës penale;
- b) sendet mbi të cilat gjenden gjurmë të veprës penale,
- c) sendet mbajtja e të cilave mund të rëndojë pasojat e veprës penale,
- d) sendet që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit;
- e) sendet që ndihmojnë në sqarimin e rrethanave të çështjes.

94. Lidhur me masat e sigurimit personal, të caktuara jashtë rasteve të flagrancës/ndalimit, është i vërtetë pohimi:

- a) vendosen nga gjykata në seancë gjyqësore, pasi palët e interesuara njoftohen paraprakisht;
- b) vendosen nga gjykata me kërkesën e prokurorit, por mbrojtësi duhet të njihet paraprakisht;
- c) vendosen nga gjykata me kërkesën e prokurorit, por në çdo rast duhet të sigurohet prania e domosdoshme të mbrojtësit dhe të pandehurit,
- d) vendosen nga gjykata në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve.

95. Në rastin e marrjes në pyetje të personit të arrestuar, kur ndaj tij është vendosur dhe ekzekutuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, marrja në pyetje nga gjykata duhet të kryhet:

- a) brenda afatit prej 48 orësh;
- b) brenda afatit prej 72 orësh;
- c) brenda afatit prej 96 orësh;
- d) brenda 3 ditëve nga zbatimi i masës;
- e) brenda një afati të caktuar nga gjykata, pasi merr mendimin e prokurorit.



96. Vepra penale të përbëra quhen:

- a) Veprat penale që çënojnë njëkohësisht dy apo më shumë marrëdhënie juridike të mbrojtura nga ligji penal;
- b) Veprat penale të cilat formohen nga dy vepra të tjera penale, të cilat mund të qëndrojnë edhe veçmas;
- c) Veprat penale që kryhen me dy ose më shumë veprime, të cilët po të shkëputen nga njëri-tjetri formojnë figurën e të njëjtës vepër penale.

97. Masat edukuese mund të jepen nga gjykata:

- a) Ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer një vepër penale;
- b) Ndaj personave që e kanë kryer veprën penale në gjendje të dehur ose nën efektin e narkotikëve;
- c) Ndaj personave që kanë bashkëpunuar me drejtësinë dhe janë përjashtuar nga dënimi;
- d) Ndaj të miturve që janë përjashtuar nga dënimi.

98. Identifikoni alternativën e saktë:

- (a) Në caktimin e dënimit gjykata mban në konsideratë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj; si dhe faktin që ky dënim duhet të ndikojë në parandalimin e kriminalitetit;
- (b) Në caktimin e dënimit gjykata mban në konsideratë parimin e individualizimit të dënimit, në varësi të kufijve të dënimit të parashikuar në ligj, duke vlerësuar që dënimi është ndëshkim;
- (c) Në caktimin e dënimit gjykata mban në konsideratë jo vetëm rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit, por edhe shkallën e faji, rrethanat lehtësuese e rënduese.

99. Identifikoni shprehjen e saktë:

- (a) Vepra penale e “vjedhjes me armë” nuk konkuron me veprën penale të “armëmbajtjes pa leje”;
- (b) Vepra penale e “vjedhjes me pasojë vdekjen” konkuron me veprën penale të “Vrasjes me dashje”;
- (c) Vepra penale e “vjedhjes me dhunë” shoqërohet me përdorimin e dhunës aty për aty, ndaj personit që është pronar i pasurisë së vjedhur;
- (d) Të gjitha shprehjet janë të sakta.

100. Nga ana objektive vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale” kryhet nëpërmjet këtyre formave:

- a) Çeljes së depozitave ose llogarive bankare anonime apo me emra fiktivë;
- b) Përdorimit të sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, për të transmetuar a përhapur njoftime publicitare për stimulimin e përdorimit të tyre, sipas ligjit për pastrimin e parave;
- c) Kryerja e veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas legjislaconit për parandalimin e pastrimit të parave.